



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 19 shkurt 2013

**Mbyllje zyrtarë të projektit të financuar nga BE-ja:  
*Forcimi i kapacitetit të institucioneve për menaxhim efikas  
me fondet e BE-së***

**(Hotel Stone Bridge)**

**Sh. e tij Aivo ORAV  
Shef i Delegacionit të BE-së**

**I nderuar Ambasador Schuurman,,**

**I nderuar Sekretar shtetëror Andonovski,**

**Të nderuar mysafir, zonja dhe zotëri,**

Ju falënderohem të gjithëve që erdhën në konferencën për përmbylljen e projektit të financuar nga BE-ja i cili e përkrahu administratën në vendosjen e sistemeve për menaxhim efikas me fondet e BE-së.

Ndërtimi i strukturave administrative në periudhën para-aderuese ka rëndësi të madhe. Institucionet dhe njerëzit që merren me programim, implementim, mbikëqyrje dhe vlerësim të fondeve të BE-së paraqesin standarde kryesore të kapaciteteve absorbuese të një shteti. Ato janë indikatorë për përgatitjen e vendit për shfrytëzim të plotë të fondeve të BE-së në mënyrë efikase dhe efektive.

Përvoja nga zgjerimi i pestë në vitin 2007 tregoi se në fazën përgatitore krijimi i kapaciteteve efikase dhe adekuate për absorbimin e fondeve të BE-së janë kyçe. Me rëndësi është që politika për forcimin e kapaciteteve për menaxhim me fondet e BE-së të përcaktohet si prioritet në nivel më të lartë politik.

Komisioni Evropian beson se monitorimi dhe sistemet për evaluim të avancuara janë të domosdoshme për qasje e orientuar drejtë rezultatit. Me rëndësi është që paraprakisht të përcaktohen qëllime dhe indikatorë të matshëm, të cilat do të përdoren për vlerësimin e rezultateve të programeve të IPA-së në vend.

Gjatë dy viteve të kaluara, BE-ja i ka përkrahur strukturat administrative për implementimin e programeve aktuale të IPA-së, në vlerë prej 1.5 milion euro duke i arritur rezultatet në vijim:

- U trajnuan rreth 400 të punësuar në administratën publike dhe u organizua trajnim në vend të punës për më se 100 operativë të strukturave IPA;
- Për më tepër, 48 persona morën pjesë në tre udhëtime mësimore në Sllovaki dhe në Spanjë;
- Ekspertët e lartë trajnuan 64 instruktorë (trajnues) për mbikëqyrjen dhe vlerësimin;
- U përgatitën planet e trajnimit dhe mjetet praktike për realizimin e mbikëqyrjes dhe vlerësimit, si dhe 8 (tetë) kurrikula për trajnim.
- Janë përgatitur mjetet e trajnuesve në gjuhët lokale;
- Janë hartuar ose rishikuar procedurat e shumta operative, për të reflektuar dhe për të vënë në funksion Udhëzuesin e BE-së për Mbikëqyrje dhe Vlerësim IPA dhe për të standardizuar procedurat e punës në mesin e institucioneve

relevante, në pajtim me përvojat më të mira të shteteve anëtare të BE-së dhe rekomandimet e auditorëve dhe vlerësuesve.

Ne jemi të bindur se vendi do të ketë sistem për mbikëqyrje (monitorim) dhe evaluim do të funksionoj mirë dhe do të kontribuoj për dhënien efikase dhe transparente të shërbimeve, që do të përgjigjet nevojave të qytetarëve.

Sistemi dhe qëndrueshmëria e përpjekjeve tona gjatë dy viteve të fundit përmes implementimit të këtij projekti do të testohet në përgatitjen e Instrumentit të ri për ndihmë para-aderuese, e ashtuquajtura IPA 2, për periudhën 2014 – 2020.

Ligjëratë për sfidat me të cilat ballafaqohen edhe shtetet anëtare të BE-së lidhur me implementimin e politikës kohezive të BE-së do të mbajë Prof. Molle, nga Universiteti Erasmus në Rotterdam.

Në fund, dua tu falënderohem të gjithë partnerëve të projektit për punën dhe përkushtimin e tyre.

Falemnderit.